



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO

Numri i lëndës: 2021:111844
Datë: 07.03.2024
Numri i dokumentit: 05422350

E.nr.1299/22

GJYKATA THEMELORE NË FERIZAJ, gjyqtari Faton Ajvazi me sekretaren juridike Makfire Reçica, duke vendosur në çështjen juridike përmbartimore të kreditorit M.R. nga Ferizaj, të cilën e përfaqëson av Elvira Heta Vata nga Ferizaj, kundër debitorit Qendra Kryesore e Mjekësisë Familjare në Ferizaj, për pagesën e borxhit dhe shpenzimeve të procedurës, më datë 07.03.2024, mori këtë:

A K T V E N D I M

PËRFUNDON procedura përmbartimore në lëndën **E.nr.1299/22**, për shkak të përmbushjes së kërkesës së kreditorit.

A r s y e t i m i

Gjykata Themelore në Ferizaj, me aktvendimin E.nr.1299/22, të datës 28.10.2022, e ka caktuar përmbartimin e propozuar nga i autorizuari i kreditorit, kundër debitorit Qendra Kryesore e Mjekësisë Familjare në Ferizaj, për pagesën e borxhit dhe shpenzimeve të procedurës, në bazë të aktgjykimit C.nr.1281/21, të datës 24.03.2022.

Meqenëse aktvendimi mbi lejimin e përmbartimit është bërë i formës së prerë dhe i ekzekutueshëm, gjykata me aktvendimet e datës 08.12.2022 dhe 07.03.2024, e ka urdhëruar Thesarin e Kosovës, që nga llogaria e debitorit, t'i transferoj shumat e mjeteve prej 1,356.07 euro dhe 263.72 euro, në llogarinë e të autorizuarit të kreditorit

Meqenëse kreditori e ka realizuar kërkesën e saj, Gjykata konstatoj se janë përmbushur kushtet ligjore nga neni 66, par 4, të LPP-së, dhe vendosi që ta përfundoj procedurën përmbartimore në këtë çështje juridike përmbartimore.

Nga sa u tha më lartë u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

GJYKATA THEMELORE NË FERIZAJ
E.nr.1299/22, më datë 07.03.2024

GJYQTARI
Faton Ajvazi